

VENDIM
Nr. 204, datë 25.3.2021

**PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR. 212, DATË 11.3.2020, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE, “PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË RINDËRTIMIT, PËR
FINANCIMIN E RINDËRTIMIT TË OBJEKTEVE ARSIMORE”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13, shkronja “b”, nënndarja “i”, dhe 36, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, miratuar me ligjin nr. 97/2019, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 7, të ligjit nr. 137/2020, “Për buxhetin e vitit 2021”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shtetit për Rindërtimin, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pas pikës 2, të vendimit nr. 212, datë 11.3.2020, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, shtohet pika 2.1, me këtë përmbajtje:

“2.1 Përdorimi i fondit, për vitin 2021, do të jetë në masën 3 928 793 173 (tre miliardë e nëntëqind e njëzet e tetë milionë e shtatëqind e nëntëdhjetë e tre mijë e njëqind e shtatëdhjetë e tre) lekë, nga i cili Bashkisë Tiranë, për vitin 2021, i transferohet fondi prej 3 928 793 173 (tre miliardë e nëntëqind e njëzet e tetë milionë e shtatëqind e nëntëdhjetë e tre mijë e njëqind e shtatëdhjetë e tre) lekë, në formën e transfertës së pakushtëzuar, për financimin e rindërtimit dhe mobilimit të objekteve arsimore, në Bashkinë Tiranë.”.

2. Ngarkohen ministri i Shtetit për Rindërtimin, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Bashkia Tiranë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe